



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1049

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE “ELSAM” SHPK, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërrimi i varëseve të gypave integral RA, RB dhe RC, njësitë B1&B2 të TC Kosova B” me numër të prokurimit KEK-23-8930-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a më 21/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e “ELSAM” SHPK me nr. 2023/1049 , e datës 22/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërrimi i varëseve të gypave integral RA, RB dhe RC, njësitë B1&B2 të TC Kosova B”, me numër të prokurimit KEK-23-8930-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a

2. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.08.2023, “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërrimi i varëseve të gypave integral RA, RB dhe RC, njësitë B1&B2 të TC Kosova B” me numër të

prokurimit KEK-23-8930-5-1-1. Ndërsa me datën 02.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “B&D Engineering SHPK dhe Novamat SHPK”- Prishtinë

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 800,000 €.

Me 08.12.2023, OE “ELSAM” SHPK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 13.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 25.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “ELSAM” SHPK me nr. 1049/23 lidhur me aktivitetin “Ndërrimi i varëseve të gypave integral RA, RB dhe RC, njësitë B1&B2 të TC Kosova B” me numër të prokurimit KEK-23-8930-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ELSAM” SHPK janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1: “Sa i përket grupit të OE i rekomanduar, dyshojmë se ky grup nuk e posedon të gjithë dokumentacionin e plotë dhe nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Edhe nga njohuritë që kemi në aspektin e përgjithshëm edhe nga kontakti për prodhuesin, dyshojmë se vizatimet e ofruara nga LISEGA (LICAD) për OE i rekomanduar për kontratë, nuk janë në përputhshmëri me vizatimet e kërkuara nga autoriteti kontraktues. Dyshojmë se tek këto vizatime mungon tipi i lidhëses, dimensionet e lidhëses. Vizatimet e kërkuara nga autoriteti kontraktues, janë vizatime të detyrueshme që do të përdoren sipas kërkesës së AK-së natyrisht duke e cekur edhe tipin e lidhëses, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.”

Pretendimi 2: “Për shkak se grupi OE i rekomanduar ka klasifikuar dokumentet e prodhuesit si sekrete afarist, ne nuk kemi mundur të shofim nëse ky grup i OE ka katalogjet, vizatimet etj. Ndërsa jemi njoftuar nga AK se as ky grup i OE e as kompania greke nuk posedojnë Autorizim nga prodhuesi. Po ashtu, në deklaratën në lidhje me origjinën e mallrave është shënuar se mallrat do të jenë me origjinë nga EU. Kjo deklaratë nuk përputhet me prodhuesin Lisega. Pra nuk ceket fare kompania LISEGA, me këtë nënkuptohet se OE i rekomanduar ka lënë mundësi manipulimi me rastin e implementimit eventual të këtij projekti. Kur kemi parasysh faktet dhe dëshmitë e lartcekura, atëherë shtrohet pyetja si dhe në çfarë mënyre janë siguruar këto dokumente meqenëse nuk kanë Autorizimin nga prodhuesi.”

Pretendimi 3: “Grupi i OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar si projekt menaxher z. T.P. Në kontratën e punës së projekt menaxherit thuhet se kontrata është lidhur për periudhën 01/03/2019-01/06/2019, me mundësi të rinovimit automatik. Nga kjo kontratë nuk dëshmohet nëse është bërë vazhdimi i kësaj kontrate, apo nëse menaxheri është akoma në mardhënie pune me kompaninë NOVOMAT. Për më tepër ky inxhinier është 71 vjeçar dhe nuk i lejohet të punoj me orar të rregullt. Po ashtu nuk ka asnjë dëshmi nga Autoritet Tatimor i Republikës së Shqipërisë, dhe edhe në CV e tij e përshkruan punën në NIVOMAT e ka shënuar 2018 deri më tani. Fjala deri tani nënkupton se ka punuar deri tani dhe kuptohet se tani nuk punon. Pra nuk dëshmohet se ky inxhinier është punëtor i Novomat.”

Pretendimi 4: “Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar specifikime teknike të nënshkruara dhe të vulosura por vetëm ka ofruar një deklaratë për specifikime teknike, prandaj edhe për këtë arsye është i papërgjegjshëm ky grup i operatorëve ekonomik. Po ashtu grupi i OE të rekomanduar për kontratë, nuk ka ofruar me dosje vizatimet e nënshkruara dhe të vulosura. Vizatimet e ofruara nga LISEGA (LICAD) nuk mund të dëshmojnë gjendjen aktuale të prodhimeve ekzistuese, prandaj edhe me këtë fakt kuptohet qartë se ky grup i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka mbështetje të plotë dhe të parëzervë nga prodhuesi Lisega, ashtu siç e kemi cekur edhe më lartë se nuk ka autorizim nga prodhuesi.”

Pretendimi 5: “Ne me datë 13/12/2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja e ka cekur se e njëjta është e pabazuar, mirëpo nuk ka ofruar fakte dhe prova konkrete për një refuzim të tillë. AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete në lidhje me pretendimet tona ankimore, prandaj me këtë rast nuk ka respektuar nenin 108/A paragrafi 9 të LPP-së. Pra AK edhe e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim edhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret se përse është refuzuar kërkesa për rishqyrtim.”

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 10, 11, 56, 59, 60, 69 të LPP –së, si dhe 40 të rregullores së prokurimit publik. Duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK B58 për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: “pretendimet ankimore janë të pabazuara pasi që: ne aktivitetin e prokurimit në fjalë tre OE të përgjegjshëm (në mesin e tyre edhe ju) kanë ofertuar me prodhues të njëjte, si rrjedhojë ofertat kanë qenë të pranueshme si nga ana teknike ashtu edhe administrative. Njëherit sqarojmë se nuk kanë qenë kërkesa të dosjes së tenderit autorizimi andaj OE i rekomanduar nuk mund të eliminohet për kërkesat të cilat nuk kanë qenë kërkesë të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Lidhur me kontratën e projekt menaxherit, në kontratën e prezantuar ceket mundësia e rinovimit automatik njëherit edhe në CV e projekt menaxherit shihet se nga viti 2018 deri tani është aktive në NOVOMAT SHPK. Duke parë se produktet në ofertat e dorëzuara nga tre ofruesit janë me prodhues të njëjte konsiderojmë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27/12/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1049/23, ndërsa me datë 17/01/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1049 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “ELSAM” SHPK, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1049 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim: Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues pas kërkesës së bërë për qasje në ofertën e OE i rekomanduar, i është ofruar një qasje shumë e kufizuar për shkak që sipas AK-së, OE i rekomanduar ka plotësuar Aneksin 3, përmes të cilit ka kërkuar që të gjithë oferta tekniko-financiare të dorëzuar të mbetet konfidenciale, përkatësisht dokumentet të cilat kanë të bëjnë me prodhuesin, certifikatat e prodhuesit, katalogjet, vizatimet, specifikimet teknike dhe skemat teknike të prodhuesit. Kështu, AK ka lejuar qasjen e OE ankues vetëm në disa dokumente të ofertës së OE i rekomanduar pa i përfshirë dokumentet e lartcekura. Neni 10 dhe neni 11 i Ligjit për Prokurimin Publik, lejojnë qasje nga palët e interesuara në ofertat e dorëzuara përmes një kërkesë me shkrim të bërë nga ajo palë, ku lejohet qasja në të gjitha dokumentet përveç atyre që janë deklaruar si sekret afarist nga ana e Operatorëve Ekonomik, por me kusht që këto të dhëna të vërtetohen si të tilla edhe nga ana e Autoritetit përkatës. Pra, në rast të tilla AK duhet të ofrojë një version të pastruar të dokumenteve apo të dhënave. Por, gjithashtu duhet të theksojmë se të njëjtat dokumente për të cilat ka kërkuar qasje OE ankues, edhe vet të njëjtat i ka paraqitur si sekret afarist përmes Aneksi 3 në ofertë, përkatësisht vizatimet, katalogjet, referencat dhe dokumentet e prodhuesit në përgjithësi. Edhe pse këto dokumente të kërkuara nuk mund të prezantohen për OE ankues për shkak të plotësimit të Aneksi 3 nga ana e OE i rekomanduar, megjithatë eksperti sqaron se të gjitha dokumentet sipas pretendimeve të ngritura janë analizuar detajisht dhe të njëjtat do të paraqiten edhe para panelit shqyrtues.

-Konstatimi 1 i ekspertit shqyrtues: “Sipas ekspertit teknik, pas shikimit të ofertave të OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit të cilët kanë qenë 3 operatorë të njëjtë kanë prezantuar materialet me të njëjtin prodhues LISEGA dhe komplet pozicionet e prezantuara janë të njëjta, numrat rendorë në vizatime, nënshkrimet në deklarata, referencat e prodhuesit, etj. Kjo

nënkupton që prodhuesi ju ka dërgua të njëjtin specifikim teknik, certifikata, nënshkrime dhe të vulosura njëjtë 2 operatoreve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet.

Poashtu lidhur me pretendimin për tabela krahasuese, katalogjet e vjetra, etj të cilat OE ankues i prezanton dhe OE i rekomanduar për kontratë nuk i posedojnë nuk qëndrojnë pasiqë të njëjtat edhe nuk kanë qenë kërkesa të AK dhe nuk janë relevante në këtë rast pasiqë këtë e përcakton qartë Udhëzuesi Nr 001/2023 për Prokurimin Publik 5.5 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, si rregull i përgjithshëm është i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët “ose e barasvlershme/ekuivalente”, dhe këtë pretendim ekspertit teknik e konsideron si të pabazuar.

-Konstatimi 2 i ekspertit shqyrtues: “Eksperti shqyrtues sqaron se për këtë pretendim të ngritur, në Dosje të Tenderit, nuk është kërkuar që OE ofertues të ofrojnë Autorizimin nga prodhuesi, për një kërkesë e cila nuk ka qenë pjesë e DT-së, AK një kërkesë të tillë nuk mund t’a përdorë as për të eliminuar dhe as për të shtuar pikë shtesë për njërin apo tjetrin operator. Ofertat e operatorëve ekonomik, gjithmonë duhet të vlerësohen në bazë të kërkesave dhe dëshmimeve të përfshira në dosje. Po ashtu, edhe Deklarata e origjinës së produkteve nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, sipas ekspertit deklarata e dorëzuar nga OE i rekomanduar tregon se origjina e këtyre produkteve është EU, ku edhe prodhuesi nga i cili janë sjellë katalogjet e produkteve është pikërisht nga EU. Po ashtu sipas ekspertit teknik, të gjitha vizatimet, katalogjet, certifikatat dhe garancionet janë në emër të këtij prodhuesi-LISEGA, andaj mundësi për manipulim nuk mund të ketë, pasi që një gjë e tillë nuk lejohet nga ana e AK-së si investitor në rastin e nënshkrimit të kontratës. Sa i përket dyshimeve të mënyrës së sigurimit të dokumenteve nga prodhuesi, sqarojmë se nuk është nën përgjegjësinë e ekspertit të verifikoj këto dyshime, për këtë gjë janë organet kompetente. Konsiderojmë që ky pretendim është i pabazuar.

-Konstatimi 3 i ekspertit shqyrtues: “Sipas kërkesave të DT-së, është kërkuar nga operatorët pjesëmarrës të: “Të prezantojnë menaxherin e projektit. Ai/ ajo duhet të ketë përvojë pune së paku 3 vite, dhe kërkohet të jetë inxhinier i diplomuar ose master i makinerisë. Të dëshmohet me diplomë, CV, kontratë punë.” OE i rekomanduar ka dorëzuar për menaxherin e projektit një kontratë (pika 12 e ofertës) në të cilën thuhet se kohëzgjatja e kontratës është me afat të caktuar, përkatësisht zbatimi i kësaj kontrate fillon me datë 01/03/2019 dhe përfundon me datën 01/06/2019 dhe gjithashtu thuhet se kontrata do të rinovohet automatikisht, në mënyrë periodike pas këtij afati nëse palët nuk e kundërshtojnë apo nuk e ndërpresin atë më parë se në afatin e saj të përfundimit. Sipas kontratës së prezantuar, kjo kontratë do të ndërpritej nëse ka ndonjë kundërshtim nga ana e ndonjëres palë, në të kundërtën do të vazhdohet automatikisht. Duke marr parasysh se nuk ka asnjë kundërshtim të paraqitur, atëherë konsiderohet se kontrata është vazhduar automatikisht pas kësaj periudhe ashtu siç është theksuar, andaj konsiderojmë se ky pretendim është i pabazuar.

Sa i përket pjesës së CV-së, përkatësisht pjesa e përvojës së punës ku është cekur se inxhinieri punon që nga viti 2018- deri më tani, eksperti sqaron se në CV shprehjet e tilla dhe të ngjashme përdoren për të treguar se kontrata nuk ka përfunduar andaj nuk mund të shkruhet një datë e përfundimit përderisa punonjësi vazhdon të jetë pjesë e asaj pune dhe pozite, prandaj në vend të datës së përfundimit, gjithmonë përdoren shprehje si ende, vazhdon, deri më tani apo shprehje të ngjashme. Andaj vlerësojmë që kjo pikë e ngritur nuk është e bazuar.

-Konstatimi 4 i ekspertit shqyrtues: “Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të ofertës së OE i rekomanduar sqaron se i njëjti ka dorëzuar edhe dokumentet nga prodhuesi, përkatësisht vizatimet e kërkuara edhe me DT, të njëjtat nga prodhuesi (pika 3 e ofertës), sa i përket pjesës së nënshkrimit dhe vulosjes, kërkesë e dosjes nuk ka qenë që këto vizatime të jenë të vulosura dhe të nënshkruara, megjithatë OE i rekomanduar ka ofruar vizatimet nga prodhuesi, ku këto vizatime përmbajnë të gjitha të dhënat e prodhuesit duke e bërë lehtë të verifikueshme vërtetësinë e tyre nga ana e AK-së. Po ashtu eksperti teknik sqaron se për secilin pozicion të kërkuar, OE dorëzon të dhëna teknike me shifër e cila përputhet me pozicionet e pramasës dhe dosjes së tenderit si dhe me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale tek neni 9.1 dhe 9.2. Vlenë të theksohet që të njëjtat i dorëzon edhe OE ankues dhe me të drejtë komisioni i vlerësimit të AK shpallë të përgjegjshëm 3 operatorët pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe shpallë fitues operatorin më të favorshëm ekonomikisht sipas Kriterëve të dhënies neni 30.1-tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë. Konsiderojmë që ky pretendim është i pabazuar.

-Konstatimi i 5 i ekspertit shqyrtues: “Eksperti shqyrtues sqaron se sipas nenit 108/A të LPP-së, pika 9 thotë se: *“Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë...”*. Sipas mendimit të ekspertit AK edhe pse ka dhënë përgjigje të shkurtër dhe gjysmake, megjithatë është përgjigjur në pretendimet e OE ankues, ashtu siç e ka zgjedhur për t’i arsyetuar këto pretendime. Andaj, vlerësojmë se ky pretendim është i pabazuar.”

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ELSAM” SHPK, Argumentimi në raportin e ekspertës shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertës shqyrtuese. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ELSAM” SHPK, të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në

aspektin meritor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertitshqyrtues dhe teknik dhe mendimi i tyre janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tyre me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertëve shqyrtues/teknik. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a. të datës 02.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërrimi i varëseve të gypave integral RA, RB dhe RC, njësitë B1&B2 të TC Kosova B” me nr. të prokurimit: KEK-23-8930-5-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- **OE - "ELSAM" SHPK**
- Arkivës së OSHP-së: